

**AKT – THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**FLOEL COMPANY SHPK**

Sot me daten 07/03/2024 (dymijë e njëzet e kater), ne ortaket themelues :

*Florian VRAHORITI*, shtetas shqipëtar, i datëlindjes 10.10.1983, lindur dhe banues në Durrës, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, me numer personal identifikimi me Nr. 131010053H

*Elsid HARIZI*, shtetas shqipëtar, i datëlindjes 01.06.1987, lindur ne Shales dhe banues në Durrës, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, pajisur me kartë identiteti me Nr. 170601104H

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008” Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007”Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ”,

Kemi vendosur të themelojme *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar me emrin “ FLOEL COMPANY” SHPK*.

**NENI 1.**  
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë emërtimin juridik “ **FLOEL COMPANY” SHPK**. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 2**  
**SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë selinë e saj në adresën:

**Durrës, Lagjja 13, Plazh, Zona Kadastrale 8518,Godine me nr pasurie 58/556.**

**NENI 3**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj ne fushen :

- Sherbime Hotelerie -Turizmi. Sherbime Turistike dhe sherbime ne plazhe. Sherbim Bar - Restorant. Hapja dhe menaxhimi i hoteleve, godinave dhe ambjenteve në të cilat ushtrohet aktivitet Hotelier. Aktivitet ne fushen e sherbimeve dhe ne fushen e organizimit te eventeve te ndryshme. Hapja dhe manaxhimi i sallave të konferencave në kuadër të aktivitetit hotelier. Hapja, manaxhimi dhe funksionimi i qendrave të rekreacionit dhe argëtimit për të rritur e fëmijë, Spa, fitness, pishina etj.
- Aktivitet ne fushen e turizmit, si agjensi turistike, udhëtimi, transportit per udhetare, guide turistike,konsulence turistike, dhenie makinash me qira, etj.

- Kryerja e tregimit të mallrave, që kanë të bëjnë me aktivitetin e hotelerisë. Tregtim të makinerive dhe pajisjeve që shërbejnë për restorante, hotele, bare, aksesore hotelerie, pajisje për mobilim, etj.
- Aktivitet në fushën imobiliare, të qiradhënies së ambjentëve tregtare dhe/ose pasurive të tjera të Paluajtshme. Dhënia e shërbimeve të konsulencës dhe ndërmjetësimit për sektorin e ndërmjetësimit tregtar, turistik, për menaxhim dhe administrim të pasurive të paluajtshme dhe jo vetëm si dhe çdo veprimtari tjetër të ligjshme.
- Tregtim artikuj të ndryshëm ushqimorë, pije të ndryshme., artikuj të konsumit, etj.
- Shoqëria sipas nevojave të aktivitetit ka të drejtën e ushtrimit të çdo aktiviteti të ligjshëm, të lejueshëm për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohej me ligj.

#### **NENI 4** **KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në 2 (dy) kuota .

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

1. **Florian VRAHORITI** zotëron 1 (një) kuotë me 50% pjesëmarrje në kapitalin e Shoqërisë me vlerë prej 50,000 lekë.
2. **Elsid HARIZI** zotëron 1 (një) kuotë me 50% pjesëmarrje në kapitalin e Shoqërisë me vlerë prej 50,000 lekë.

Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar duhet që të nënshkruhen në tërësinë e tyre nga Ortakët themelues dhe të shlyhen krejtësisht, si për rastet kur përfaqësojnë kontribute në para ashtu edhe në natyrë. Ato nuk mund të përfaqësojnë kontribute në shërbime

#### **NENI 5** **KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

#### **NENI 6** **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Administrator i shoqërisë do të jetë **Florian VRAHORITI**, e cila emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqësojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

**NENI 7**

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**NENI 8**

**NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjane për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

**Neni 9**

**LIKUIDIMI**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

**NENI 10**

**Dispozitat e fundit**

Shoqëria respekton ligjin dhe Statutin që është pjesë e pandarë e këtij Akti Themelimi.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKB-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e Shoqërive me përgjegjësi të kufizuar

**ORTAKET THEMELUES TE SHOQËRISË**

**Florian VRAHORITI**

FLORIAN VRAHORITI



**Elsid HARIZI**

Elsid Harizi

